



KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES

Nr. 04, datë 26.02.2021

**Për miratimin e “Raportit vjetor të
Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2020”**

Në mbështetje të nenit 7, të nenit 52 pika 1, shkronja (l) dhe të nenit 53, pika 5, shkronja (ë) të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 7, pika 6, të nenit 8, pika 2, shkronja “d” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 dhe të nenit 18 pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin Vjetor të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2020, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për paraqitjen e raportit vjetor pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Autoritetit Mbikëqyrës, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi dhe të Raportit Vjetor në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar